

VENDIM
Nr. 41, datë 23.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 90, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 19, pika 1, germa “f” dhe 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 90, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE miraton “Rregullat operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit dhe Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti